



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 3 dhjetor hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për leje për apelim të vendimit për pranimin si provë të një dokumenti nga një gjykim në TPNJ lidhur me sjelljen dhe besueshmërinë e një dëshmitari. Trupi Gjykses konstatoi se pjesa relevante e dokumentit u diskutua me dëshmitarin, dëshmitari dha komentet e veta në lidhje me të gjatë pyetjeve të palës kundërshtare, dhe se rrjedhimisht nuk ishte e nevojshme që dokumenti të paraqitej më tej për pranim si provë. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është ekskluzivisht përgjegjësi e Trupit Gjykses. Trupi Gjykses përsëriti se provat, përfshirë mospërputhjet e mundshme, do t'i vlerësojë pas mbylljes së fazës së paraqitjes së provave dhe në kontekst të tërësisë së provave që i janë paraqitur.

Gjatë kësaj jave, dëshmitari Sokol Bashota dha dëshmi në sallën e gjyqit. Trupi Gjykses kishte njoftuar se kishte marrë vendim për ta detyruar z. Bashota të dëshmonte, mbi bazën e dëshmisë unike të tij dhe mundësisë së kufizuar për vetinkriminim. Trupi Gjykses e siguroi dëshmitarin se dëshmia e tij do të jepej në seancë të mbyllur dhe nuk do të përdorej kundër tij në ndjekje penale të mëvonshme para Dhomave të Specializuara. Sidoqoftë, pas konsultimit me mbrojtësin kujdestar të tij, dëshmitari bëri të ditur se dëshironte të jepte dëshminë në seancë të hapur.

Z. Bashota ishte dëshmitari i 109-të që dha dëshmi në sallë të gjyqit në këtë çështje gjyqësore. Ai e përfundoi dhënien e dëshmisë sot paradite dhe dëshmitari i 110-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë. Dëshmitari po dëshmon me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes së lexuar nga ZPS-ja në sallën e gjyqit, dëshmitari u arrestua më 1999 nga anëtarë të armatosur të UÇK-së dhe u çua në një vend ku u mor në pyetje dhe u keqtrajtua dhe ku dëshmitari dëgjoi britma të njerëzve të tjerë që po keqtrajtoheshin.

Pas seancë së sotme, seanca e ardhshme në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 13 janar 2025, në orën 09:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, Trupi Gjykses më 28 nëntor lëshoi vendimin mbi parashtrimin e përbashkët për redaktimet e propozuara në dosjen gjyqësore përfundimtare të Mbrojtjes dhe përgjigjen e Mbrojtjes ndaj kërkesës së Mbrojtësit të Viktimave për zhdëmtim, dhe urdhëroi Mbrojtjen që të dorëzonte versionet e redaktuara publike të këtyre dokumenteve, sipas udhëzimeve në vendim. Trupi Gjykses theksoi se kishte vlerësuar çdo redaktim të propozuar rast pas rasti, duke marrë parasysh, ndër të tjera, parashtrimet e Mbrojtjes, Prokurorisë, Mbrojtësit të Viktimave dhe Njësisë për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, parimin e procesit publik dhe detyrën e Trupit Gjykses për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e viktimave dhe dëshmitareve.





Më 4 dhjetor, Trupi Gjykses I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Haxhi Shalës. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku i arratisjes, si dhe rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë vepra penale të mëtejshme. Megjithëse theksoi se kushtet e propozuara më parë nga Mbrojtja do të mund të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e arratisjes, Trupi Gjykses konstatoi se ato nuk zvogëlojnë rrezikun që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit. Konkretisht, Trupi Gjykses mori parasysh se në rast se lirohet, z. Shala do të ketë motivin, mjetet dhe mundësinë për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 ose për të manipuluar provat në ndonjë mënyrë tjetër. Trupi Gjykses konstatoi se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Më 3 dhjetor 2024, Autoriteti Emërues, gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano, emëroi gjykatësin Pjotër Hofmanski në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara. Gjykatës Hofmanski është nga Polonia. Gjykatës Hofmanski u emërua pas dorëheqjes së gjykatësit Antonio Balsamo si gjykatës i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për arsye profesionale. Gjykatësi Balsamo do të mbetet gjykatës në Regjistër.

Autoriteti Emërues emëroi gjykatësin Hofmanski në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese si një nga tre gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, në vend të gjykatësit Balsamo.

Kemi marrë një numër pyetjesh nga gazetarë sot paradite lidhur me raportet aktuale në Kosovë.

Në këtë moment, vetëm mund t'ia referoj pyetjet Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe të lexoj një deklaratë të lëshuar nga Prokuroria më herët sot.

Në deklaratë lexohet:

ZPS-ja kryen operacione gjatë hetimeve për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) po kryen operacione në vazhdimësi në Kosovë në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Operacionet e ZPS-së janë autorizuar nga ana gjyqësore prej Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe janë mbështetur nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Pyetje

Një gazetar pyeti nëse Dhomat e Specializuara prisnin arrestime të mëtejshme dhe Angela shpjegoi që kjo do të ishte një pyetje për Zyrën e Prokurorit të Specializuar që është një institucion më vete. Një gazetar tjetër pyeti për një gabim tipografik në faqen e internetit e cila u korrigjua menjëherë.

